



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Integrimit European*  
*Ministarstvo za Evropske Integracije/Ministry of European Integration*

---

*Ministria e Integrimit European duke u bazuar ne Ligjin për Shërbimi Civil të Republikës se Kosovës L.Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës shpall konkurs :*

### Divizioni për Buxhet dhe Financa

1. Zyrtar financiar  
Referenca e titullit të punës (MIE-DBF-004)  
Koeficienti : 7  
Vendi: Prishtinë

### Qëllimi vendit të punës:

- Shpenzimi i buxhetit bazuar në planin e keshit dhe sipas kërkesave të aprovuara nga zyrtarët aprovues dhe autorizues të buxhetit.
- Rezultate të pritshme të kësaj pozite janë:  
koordinimi efektiv, shpenzimeve dhe raportimeve të shpenzimeve buxhetore

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Planifikimi i shpenzimeve
- Shpenzimi i buxhetit bazuar në planin e prokurimit
- Raportimi periodik, vjetor dhe sipas nevojës i shpenzimit të buxhetit

- Mbajtja e kontakteve me MF-Thesar
- Regjistrimi i të gjitha transaksioneve të kryera

Regjistrimi i të gjitha transaksioneve të kryera

**Shkathtësitë e kërkuara** (kualifikimet, përvojat si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

- Diplomë universitare në ekonomi ,
- Tri vite përvojë pune
- Njohje e mirë e programeve kompjuterike (Microsoft Office, Internet, etj.)

### **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve**

Formulari për aplikim dhe përshkrimi i punës mund të merret në receptionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.) gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga Web Faqja e internetit të MIE-së.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat etj, mund të dorëzohen:

- Drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MIE-së si dhe
- Përmes postës.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione me të dhëna të sakta. Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave ose ofrimit të informatave jo të sakta, aplikacioni refuzohet, gjithashtu përdorimi i formularëve jozyrtar rezulton në refuzimin e menjëhershëm të aplikimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar(postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit bëhet në përputhje me LSHCK, në të cilën është e përfshirë perioda e punës provuese prej një (1) viti.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data 20.08.2013, deri 03.09.2013 në ora 16.00.

Për informata shtesë mundë të kontaktoni Zyrën e Personelit të MIE-së,

në telefonin: 038 200 27-006

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Web-Faqene Ministrisë:  
[www.mei-ks.net](http://www.mei-ks.net)

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.